



FIF – Digjitalizimi në Ballkanin Perëndimor - PCBA

Shteti:	SHQIPËRI
Numri i Projektit:	56614
Sektori i Biznesit:	Kredi depozituese (banka)
Tipi i Njoftimit:	PRIVAT
Kategoria Mjedisore:	Institucione Financiare
Data e Aprovimit:	19 Gusht 2025
Statusi:	Miraturar
Publikimi i PSD:	26 Gusht 2025

Sipas seksionit 1.4.2 (iii) të Direktivës për Qasjen në Informacion: "Për Projektet e miratuara nga menaxhmenti i Bankës ku Bordi i Drejtorëve ka deleguar autoritetin e miratimit, PSD duhet të publikohet në fillim të periudhës përkatëse të njoftimit pa kundërshtime për një vend anëtar të Bankës në përputhje me Nenin 13 (iii) të Marrëveshjes Themeluese të BERZH.

Përshkrimi i Projektit

Një kredi deri në EUR 3.0 milionë për ProCredit Bank Albania (PCBA) që do të disbursohet në tre këste të barabarta (EUR 1.0 milionë secila) në kuadër të programit BERZH "Digjitalizimi në BP". Këstet e dyta dhe të treta do të jenë të paangazhuara dhe miratimi do t'i delegohet strukturës drejtuese.

Objektivat e Projektit

Fondet e Bankës do të përdoren për të ofruar financim të specializuar që do të mbështesë automatizimin, digjitalizimin, përmirësimin e konkurrencës dhe promovimin e teknologjive të gjelbra për NVM-të që përmbushin kriteret e Politikës përkatëse. Të paktën 60% e investimeve totale do të jenë për projekte të automatizimit dhe digjitalizimit që përmbushin kriteret e pranimit, nga të cilat të paktën 60% duhet të përmbushin kriteret GET. Për më tepër, të paktën 60% e investimeve totale duhet të përmbushin kriteret GET.

Ndikimi në Tranzicion

ETI 65

Projekti kontribuon në objektivat e FIF, duke mbështetur cilësitë e Ndikimit në Tranzicion të **Konkurrencës** dhe **Qëndrueshmërisë mjedisore**:

Konkurrenca: Projekti do të inkurajojë konkurrencën e NVM-ve duke zgjeruar huadhënien digjitale për NVM-të në përputhje me standardet e FIF.

Qëndrueshmëria mjedisore: Projekti do të kontribuojë në cilësinë e TI-së së qëndrueshmërisë mjedisore duke adresuar eficiencën e energjisë si pjesë e aktiviteteve që përmbushin kriteret për investime të NVM-ve.

Informacioni për Klientin

PROCREDIT BANK ALBANIA SHA

ProCredit Bank Albania ("PCBA") është një bankë e vogël e orientuar drejt ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri me një madhësi tregu prej 2.3% në aspektin e totalit të aktiveve dhe 4.0% në aspektin e kredive që nga fundi i tremujorit të tretë 2024. PCBA është një institucion financiar i orientuar drejt zhvillimit me përvojë të gjerë në nxitjen e rritjes së qëndrueshme ekonomike. Banka njihet gjerësisht për fokusin e saj të fortë në mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (MSME), promovimin e investimeve në teknologji të gjelbra dhe me efikasitet energjetik, dhe nxitjen përpara të dixhitalizimit të shërbimeve bankare për të ofruar zgjidhje transparente, moderne dhe efikase për klientët e saj.

BERZH Përmbledhja Financiare

EUR 3,000,000.00

Kosto Totale e Projektit

EUR 3,000,000.00

Vlera e shtuar

Ky projekt përfshin ofrimin e financimeve afat-mesme me periudhë të gjatë maturimi, të cilat nuk janë të disponueshme në tregun e financimeve me depozitat afatshkurtra, si dhe ekspertizën në automatizimin, digjitalizimin dhe huadhënien për qëndrueshmërinë mjedisore.

Bashkëpunimi teknik do të mundësojë ngritjen e kapaciteteve të brendshëm të UB-së për të shtuar përpjekjet për kursimin e energjisë nëpërmjet teknologjisë digjitale, në përputhje me kërkesat mjedisore dhe sociale (E&S), ndërkohë që 60% e nën-huave pritet të përmbushin standardet GET. Komponenti Gender SMART promovon qasjen e njëjtë në financime për NVM-të e drejtuar nga

gratë, me trajnime të specializuara për të rritur gatishmërinë për digjitalizim, interesimin ndaj projekteve dhe strategjitë e përgjegjshme gjinore.

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

E kategorizuar Institucion Financiar (ESP 2024). PCBA është një klient ekzistues i BERZH-it dhe aktualisht po përmbush Kërkesat Mjedisore dhe Sociale (ESRs) 2, 4 dhe 9 të BERZH-it sipas ekspozimeve të saj ekzistuese. Nënprojektet e pranueshme sipas këtij kuadri do të mbështesin: i) huadhënien e mëtejshme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të pranueshme në Shqipëri për të mbështetur zgjerimin e biznesit dhe investimet e pranueshme për GET (56613 - WB GOLD); ii) një kombinim të financimit të specializuar për automatizimin, dixhitalizimin, konkurrueshmërinë dhe teknologjitë e gjelbra për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të pranueshme, duke ndjekur Deklaratën përkatëse të Politikës (56614 - Go Digital in WB); dhe iii) ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të udhëhequra nga gratë, në përputhje me Deklaratën përkatëse të Politikës (56615 - WiB II). Këto nënprojekte pritet të kenë rrezik të ulët deri në mesatar mjedisor dhe social. Rreziqet kryesore mjedisore dhe sociale lidhen me ekspozimin e mundshëm ndaj sektorëve me rrezik më të lartë, si dhe me çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë (OHS). Vlerësimi i duhur mjedisor dhe social është kryer nëpërmjet një shqyrtimi të raportit më të fundit vjetor mjedisor dhe social (2024) të klientit dhe informacionit të disponueshëm publikisht. PCBA ka një Sistem Menaxhimi Mjedisor dhe Social (ESMS) që konsiderohet i përpjesëtuar me profilin e rrezikut të nënprojekteve të pranueshme. Klienti publikon një raport vjetor të ndikimit si pjesë të deklarimeve të tij të qëndrueshmërisë.

Klienti pritet të mirëmbajë Sistemin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social të tij për të vlerësuar, menaxhuar dhe monitoruar në mënyrë efektive rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale, në përputhje me ESR-të 2, 4 dhe 9 të BERZH-it sipas ESP-së (2024). Kjo përfshin mbajtjen e një politike të burimeve njerëzore (HR), një mekanizëm të brendshëm ankesash dhe procedura të shëndetit dhe sigurisë në punë (OHS). Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social duhet gjithashtu të sigurojë pajtueshmërinë me listën e përjashtimeve mjedisore dhe sociale të BERZH-it dhe përputhjen me udhëzimet përkatëse të BERZH-it për institucionet financiare. Nën-huamarrësit e financuar nga klienti duhet të jenë në përputhje me të gjitha ligjet kombëtare mjedisore, sociale, shëndetësore, të sigurisë dhe të punës. PCBA do të paraqesë raporte vjetore mjedisore dhe sociale të BERZH, duke përshkruar zbatimin e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social, përputhshmërinë me kërkesat e BERZH, rezultatet e shqyrtimit të nënprojekteve dhe çdo incident material mjedisor dhe social. Klienti gjithashtu kërkohet të zbulojë publikisht informacionin mbi ESMS-në e tij pas ESP 2024. Nëse financimi i BERZH-it përdoret për nënprojekte të energjisë së rinovueshme, këto duhet të përmbushin kriteret e pranueshmërisë mjedisore dhe sociale të BERZH-it për burimet e rinovueshme të energjisë, së bashku me çdo kërkesë shtesë të përcaktuar në Deklaratën përkatëse të Politikës.

60% e financimit të BERZH-it në kuadër të Kredisë Go Digital klasifikohet si financim i gjelbër, pasi mbështet aktivitetet për të arritur objektivat e zbutjes dhe përshtatjes ndaj klimës. Shpërndarja bëhet në përputhje me metodologjinë për të përcaktuar shpërndarjen e financimit të gjelbër të investimeve të BERZH-it.

Bashkëpunimi Teknik

Programi mbështetet me fonde grant nga BE-ja për financimin e (i) pagesave të nxitjessë investimeve për nën-huamarrësit (Jo-TC) prej EUR 22.5 milionë dhe (ii) Bashkëpunimi Teknik prej EUR 4.48 milionë.

TC: Bashkëpunimi teknik përfshin mbështetjen e NVM-ve nga Konsulenti i Programit për përgatitjen e planeve për investime të financueshme dhe për të mbështetur PFI-të në zhvillimin e një portofoli të nëninvestimeve të pranueshme, si dhe asistimin me zbatimin, monitorimin dhe verifikimin e zbatimit teknik dhe përputhshmërisë së investimeve përpara se të lëshohen pagesat nxitëse për NVM-të përkatëse. Gjinia është integruar në nivelin e programit me fokus specifik në NVM-të e drejtuara nga gratë, me trajnime për të shtuar konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e operacioneve të biznesit të përfituesve përfundimtarë.

Jo-TC: Bashkëpunimi jo në nivel teknik përfshin deri EUR 0.3 milionë për incentiva investimi për nën-huamarrësit për investimet e zbatuara në automatizim dhe dixhitalizim në përputhje me kriteret e pranueshmërisë të specifikuara në Deklaratën e Politikës së Programit.

Informacion Kontakti i Kompanisë

Blerta Selamaj

blerta.selamaj@procredit-group.com

+355689031068

<https://www.procreditbank.com.al/>

Rruga "Dritan Hoxha", pranë Pallatit të Sportit "Asllan Rusi", Kodi Postar 1026, Tiranë, Republika e Shqipërisë.

Përditësimi i fundit i PSD-së

26 Gusht 2025

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH.

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe çdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.